



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPKI	Nr Prot Br Prot 06-1598/20 Prot No
Nr lfaq Broj stranica 02	Data Datum 03.08.2020 Date



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. **AKK-DPKI-06-1173/20**, për zyrtarin e lartë z. Agron Beka, Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Publik "Isa Boletini", në Mitrovicë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtuftjeshëm: Agjencia) ka shqyrtuar rastin për konflikt të interesit me numër protokolli **AKK-DPKI-06-1173/20**, lidhur me zyrtarin e lartë z. Agron Beka, Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Publik "Isa Boletini", në Mitrovicë, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Agron Beka, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Publik "Isa Boletini", në Mitrovicë, i njëjti mbante funksionin e Kryetarit dhe Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatat jo-qeveritare "Association for Law Advocacy and for Democratization of the Law System" dhe "Association of Agencies and Agents for Property Claims". Përmes shkresës zyrtare nr. **DPKI-06-515/20**, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike, verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. **DPKI-06-776/20**), zyrtari i lartë z. Agron Beka figuron të jetë Kryetar dhe Person i Autorizuar në OJQ-të në fjalë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik,



Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1173/20 e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Agron Beka për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Mëpas pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë i cili e ka njoftuar atë gjerësisht lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të mbajë funksion drejtues e as të jetë përfaqësues i autorizuar në OJQ, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

si dhe nenin 14 paragrafi 1, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Agron Beka është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin (shkresat zyrtare DPKI-06-1495-1/20 dhe DPKI-06-1558/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Agron Beka ka dhënë dorëheqje nga Funksion Drejtues në Organizatat jo-qeveritare “Association for Law Advocacy and for Democratization of the Law System” dhe “Association of Agencies and Agents for Property Claims”, si dhe i njëjti nuk figuron më të jetë as Person i Autorizuar në OJQ-të në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Agron Beka, Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Publik “Isa Boletini” në Mitrovicë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit